

## PËRSHKRIM POZICIONI

<b>Titulli i pozicionit</b>	<i>Senior Designer</i>
<b>Raporton tek</b>	Drejtor i Marketingut

## Rolet dhe Përgjegjësitë

- Forcimi i ADN-së së markës sonë përmes grafikave statike, animacioneve dhe videove bindëse që përshtaten me audiencën tonë dhe nxisin besnikërinë ndaj markës, të gjitha duke ruajtur identitetin vizual të EasyPay.
- Konceptim dhe dizejnim i të gjitha materialeve vizuale të kompanisë dhe produkteve të saj për *website, rrjete sociale, portale, outdoor apo hapësira të tjera reklamuese*.
- Konceptim dhe dizejnim i materialeve për rrjetin e pikave të shitjes, si: *flyers, posters për pika fizike, roll up, banner etj.*
- Konceptim dhe dizejnim i elementeve grafikë, dhe adaptimi i tyre në industrinë Fintech si: *infographics, ilustrime, prezantime etj.*
- Konceptim dhe përgatitje e materialeve audiovizuale për fushatat ATL & BTL.
- Në bashkëpunim me ekipet përgjegjëse, të krijojë dhe përshtasë UI / UX të shërbimeve të kompanisë në aplikacionin web dhe mobile.
- Duhet të udhëzoni dhe mbështesni Junior designers në ekip.

## Kërkesat dhe njohuritë e nevojshme

- Mbi 3 vite eksperience pune në kompani dhe role të ngjashme
- Aftësi shumë të mira dhe ekspertize në programe design si Adobe CC Suite & Figma.
- Preferohet një diplomë Bachelor/Master në Art dhe Design.
- Vlerësohen gjithashtu aftësi bazë të Motion Design.
- Një sy të mprehtë për estetikën e kombinuar me një kuptim të gjerë të marketingut.
- Aftësi të shkëlqyera organizative dhe komunikuese. Ky rol do të jetë shumë ndërfunksional me përfshirjen në projekte dhe iniciativa të ndryshme.

## Përfitimet

- Një mundësi e shkëlqyer për zhvillim personal. Në departamentin e marketingut, ne jemi një ekip i vogël dhe besojmë se është vendi i përsosur për t'u rritur dhe mësuar.
- Mundësi për të sjellë ide të reja në një ekip ku nuk do të dëgjoni kurrë shprehjen "*... sepse kështu i kemi bërë gjithmonë gjërat më përpara*"
- Zyra jonë në Tiranë ndodhet direkt në zonën e Bllokut, shumë afër dhe e aksesueshme nga kudo.
- Team Retreats - Të paktën dy herë në vit i gjithë ekipi ynë organizon udhëtime ekipore për t'u argëtuar dhe për të qenë të gjithë së bashku në një ambient të ndryshëm.

Arritëm të zgjonim interesin tuaj? Të lutem na dërgoni dokumentet tuaja të aplikimit (CV dhe portofolin e punëve) në adresën e emailit: [marketing@easypay.al](mailto:marketing@easypay.al).